



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Inspektor, Drejtorja e Kontrollit të Terrenit, Sektori Mbështetjes së Ekzekutimit të Vendimeve të Prishjes (Kategoria III-b).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë(Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë), (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësimi nga MAS);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Inspektori ka për detyrë si më poshtë:

Inspektori i Sektorit të Mbështetjes së Ekzekutimeve të Vendimeve të Prishjes varet nga Përgjegjësi i Sektorit dhe kryen këto detyra:

1. Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
2. Në zbatim të detyrave që i ngarkohen, ushtron kontrole dhe bën verifikime të drejtëpërdrejta në terren, si dhe raporton konkluzionet tek përgjegjësi i sektorit;
3. Mban përgjegjësi për përcjelljen e informacionit të rezervuar në kushte të larta diskrecioni dhe njëkohësisht për ruajtjen e konfidencialitetit të nevojshëm gjatë ndërhyrjeve të ekzekutimit;
4. Sipas porosive të eprorëve, kujdeset për dokumentimin filmik dhe/ose fotografik të realizimit të ndërhyrjeve të ekzekutimit;
5. Siguron territorin ku realizohet ndërhyrja, me qëllim parandalimin e aksidenteve apo futjen e personave të paautorizuar.

Dokumentat që aplikanti për Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Terrenit, Sektori Mbështetjes së Ekzekutimit të Vendimeve të Prishjes duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 13.10.2023, ora 14.00